

V E N D I M
Nr.555, datë 1.8.2003

**PËR MBYLLJEN TËRËSORE TË DISA MINIERAVE TË HEKURNIKELIT, BAKRIT,
FOSFORITEVE DHE KROMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të mos vlerësohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë dhe t’u nënshtrohen procesit të mbylljes, privatizimit ose likuidimit minierat, si më poshtë vijojnë:

1.1 Miniera e hekurnikelit Radokal	Librazhd, Elbasan
1.2 Miniera e hekurnikelit Pishkashi Verior	Librazhd, Elbasan
1.3 Miniera e hekurnikelit Golem	Librazhd, Elbasan
1.4 Miniera e hekurnikelit Guri i Pishkashit	Librazhd, Elbasan
1.5 Miniera e hekurnikelit Çervenakë Perëndimore	Pogradec, Korçë
1.6 Miniera e hekurnikelit Çervenakë Lindore	Pogradec, Korçë
1.7 Miniera e nikelsilikatit Bitinckë (pjesa e palicencuar)	Bilisht, Korçë
1.8 Miniera e bakrit Kanisqel	Korçë
1.9 Miniera e fosforiteve Fushë-Bardhë	Gjirokastrë
1.10 Miniera e fosforiteve Gusmar	Tepelenë, Gjirokastrë
1.11 Vendburimi i kromit Kodra e Lerës	Bulqizë, Dibër
1.12 Traverbangët e NNMinierës Bulqizë Qafë-Lamë	Bulqizë, Dibër
1.13 Traverbangu Lucanë, thellësi, Batër	Bulqizë, Dibër
1.14 Rampa Qafë-Buall	Bulqizë, Dibër
1.15 Vendburim Qafë-Buall	Bulqizë, Dibër
1.16 Barta Jugore thellësi e sipërfaqe, Batër	Bulqizë, Dibër

2. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës brenda muajit gusht 2003, të fillojë procedurat e hartimit të projekteve dhe të bëjë preventivat e mbylljes së minierave të përmendura në pikën 1, ndërsa mbyllja e tyre të realizohet gjatë vitit 2004.

3. Makineritë, pajisjet, materialet dhe objektet sipërfaqësore të privatizohen, në përputhje me legjislacionin në fuqi ose të transferohen për t’u përdorur për nevoja të organeve të pushtetit vendor.

4. Fondet që nevojiten për mbylljen e këtyre minierave, të përballohen nga fondet buxhetore për mbylljen dhe konservimin e objekteve minerare të Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës.

5. Punonjësit, të cilët deri më 1.1.2003 kanë qenë në marrëdhënie pune dhe do të jenë të tillë deri në çastin e mbylljes së minierave, të trajtohen për 1(një) vit me pagën minimale në shkallë vendi.

6. Periudha 1-vjeçare të njihet si vjetërsi pune, për efekt pensioni dhe të shënohet e tillë në librezën e punës.

7. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi, e kanë ata punonjës, që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në fushën e punësimit ose të vetëpunësimit. Në rast të kundërt, u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.

8. Pagesa e punonjësve, që dalin të papunë nga zbatimi i këtij vendimi, si dhe e kontributeve për sigurimet shoqërore të bëhet nga zyrat e punës në rrethet përkatëse. Fondet e nevojshme për këtë qëllim, për vitin 2004, të programohen nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale.

9. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimit përkatës në zbatim të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano